

Pamja e Pjesëmarrësve në

Prezantuesi/ja

The screenshot shows a VoiceBoxer chat window. At the top left is the VoiceBoxer logo and the text "Introducing VoiceBoxer". At the top right, it says "Test VoiceBoxer Connected" with a user profile icon. The main chat area contains a presentation slide on the left and a chat message on the right. The slide is titled "Digital Skills & Learning" and features various icons (graduation cap, laptop, smartphone, shopping cart, lightbulb, people, @ symbol, camera, microphone) and the text "Re-thinking Digital Skills & learning in SEET countries EU instruments and tools" and "23 June 2020". The chat message says "Pyetjet mund ti bëni këtu!". At the bottom, there is a "LANGUAGE ENGLISH" dropdown menu and a text input field with the placeholder "Enter your message here...".

VOICEBOXER | Introducing VoiceBoxer

Test VoiceBoxer Connected

Paraqitja

Digital Skills & Learning

Re-thinking Digital Skills & learning in SEET countries
EU instruments and tools

23 June 2020

CHAT CHANNEL GENERAL

Pyetjet mund ti bëni këtu!

CONNECTED

LANGUAGE ENGLISH

Enter your message here...

Zgjidhni gjuhën që preferoni



Aftësitë & Mësimi Dixhital

Rikonceptimi i Aftësive & i Mësimit Dixhital në vendet e Europës Juglindore dhe Turqi
Mjetet dhe instrumentet e BE-së



MIRËSEVINI

- Transformimi dixhital është ndër përparësitë kryesore të Komisionit të ri
- Arsimi dhe trajnimi janë mundësues kyç
- Mjete dhe nisma të BE-së në mbështetje të strategjive të arsimit dixhital
- ETF në qasjen e vet strategjike lidh aftësitë dixhitale dhe sigurimin e kompetencave me përdorimin e metodave inovative dixhitale për mësimdhënien dhe mësimin.

Përtej
Emergjencës
CoVid19





Sot




Mjete dhe instrumente të BE-së për Mësimin dhe Aftësitë Dixhitale

SOT

- **Nismat e ETF në mbështetje të Aftësive dhe Mësimit Dixhital në vendet e Europës Juglindore dhe Turqi**
Alessandro Brolopito, European Training Foundation
- **Drejt planveprimit të ri të Komisionit për arsimin dixhital**
Georgi Dimitrov, Drejtorja e Përgjithshme për Arsimin dhe Kulturën, Komisioni Europjan
- **Adresimi i sfidave të arsimit dhe aftësive dixhitale përmes kornizave dhe mjeteve europjane të aftësive dixhitale**
Yves Punie, Qendra e Përbashkët për Kërkime (JRC), Komisioni Europjan
- **Qasja e parë e politikës dhe mjetet e saj për të promovuar arsimin dhe aftësitë dixhitale**
Fanny Seree and Christophe Masson, Drejtorja e Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat për Zgjerimin (DG NEAR), Komisioni Europjan

Përtej
Emergjencës
CoVid19





Nismat e ETF në mbështetje të Aftësive dhe Mësimit Dixhital në vendet e Europës Juglindore dhe Turqi

Alessandro Brolopito

European Training Foundation, Torino

Rikonceptimi i Aftwsive dhe Mwsimit Dixhital nw vendet e Europws Juglindore dhe Turqi

Tre evente online tw ndwrlidhura

Seminari
SELFIE

1

Instrumentet
dhe Mjetet e BE-së

3

Bashkëpunimi
Rajonal

2

Seminari Online SELFIE - 04

Qershor

Programi SELFIE në vendet e Europës Juglindore dhe Turqi: është realizuar faza pilot në gjashtë vende, ndërsa në tre vende jemi tashmë në fazë më të përparuar


173.383 përdorues
1.113 shkolla

Shqipëri
Kosovë*
Mal i Zi
Maqedoni e Veriut
Serbi
Turqi



Seminar Online SELFIE - 04 Qershor


Rezultatet kryesore



Bashkëpunimi Rajonal dhe një Rast Studimor Webinar i ETF - 17 Qershor

- **ETF – Vlerësimi i Mësimit Dixhital në Distancë në përgjigje të mbylljes së shkollave - CoVid19**
- **KRB – Aftësitë dixhitale në Ballkanin Perëndimor – Nevojat dhe Sfidat që kemi përpara**
- **ERI SEE – Sistemet e analizës së nevojave dhe aftësitë dixhitale për edukatorët në vendet e Europës Juglindore dhe Turqi**
- **Ministria e Arsimit Kombëtar, Turqi – Mbështetja e Aftësive Akademike dhe Psikosociale të Nxënësve përmes Arsimit në Distancë**

Skedat dixhitale të të dhënave të ETF Aftësitë dhe Mësimi Dixhital në sektorin e AFP-sw



Skedat dixhitale të të dhënave të ETF Aftësitë dhe Mësimi Dixhital në sektorin e AFP-sw

Skeda tw dhwnash mbi Mwsimin dhe Aftwsitw Dixhitale
dhe Mwsimin Dixhital dhe Online nw AFP

Botuar nw Qwrshor 2020:

- Bosnja dhe Hercegovina
- Kosova*


2018: Shqipwria, Maqedonia e Veriut dhe Turqia

2017: Mali i Zi, Serbia

Pyetje & Përgjigje

Drejtojani pyetjet tuaja

Alessandro Brolpito





Drejt planveprimit të ri të arsimit dixhital të Komisionit

Georgi Dimitrov

Drejtoria e Përgjithshme për Arsimin dhe Kulturën, Komisioni Europjan



Përditësim mbi Planveprimin e Arsimit Dixhital

Georgi Dimitrov, Zëvendës Kryetar i Inovacionit dhe EIT, Drejtorja e Përgjithshme për Arsimin dhe Kulturën (DG EAC), Komisioni Europjan
“Rikonceptimi i rolit të mësimit dixhital dhe sigurimi i aftësive dixhitale në vendet e Europës Juglindore dhe Turqi – Mjetet dhe Instrumentet e BE-së”,
Webinar i ETF, 23 Qershor 2020

Planveprimi i Arsimit Dixhital 2018

- **Adoptuar** në Janar 2018, si pjesë e nismave në mbështetje të krijimit të Zonës Europjane të Arsimit.
- **Qëllimi:** të mbështesë Vendet Anëtare dhe institucionet arsimore në përshtatjen me epokën dixhitale.
- **Shtrirja:** nivelet primare, dytësore dhe të treta të arsimit formal.
- **Qasja e fokusuar:** njëmbëdhjetë aksione pjesë e tre përparësive:



- **Kohëzgjatja:** deri në fund të vitit 2020




Përditësim mbi Planveprimin e Arsimit Dixhital

*‘My priority will be to get Europe up to speed on digital skills for both young people and adults by **updating the Digital Education Action Plan**. We need to rethink education by using the potential the internet provides to make learning material available to all, for example by the increased use of massive open online courses. Digital literacy has to be a foundation for everyone’.*

Political Guidelines of the President von der Leyen

Kriza e COVID-19

- Një sfidë pa precedentë për sistemet e arsimit dhe trajnimit
- Mbyllja e godinave të shkollave dhe kampuseve preku më shumë së 100 milionë studentë në BE
- Kalimi i papritur dhe në shkallë të gjerë në modele arsimi dixhital përfshi mësimin dhe mësimdhënien online



Schools (ISCED 1-3)



Higher Education Institutions

Komunikimi i brezit të ardhshëm



- Programi i përditësuar i punës së Komisionit 2020
- Adoptimi i Përditësimit të Planveprimit të Arsimit Dixhital për tremujorin e tretë 2020 në kontekstin e planit të rimëkëmbjes.

Sfida kryesore 1 – Kapaciteti Dixhital

Provat tregojnë se shumica e sistemeve arsimore nuk ishin gati tju ofronin njëlloj të gjithë studentëve mundësi për të mësuar online ose në mënyrë hibride të një cilësie të lartë:

- Mesatarisht, **9% e nxënësve 15-vjeçarë nuk kanë një vend të qetë në shtëpitë e tyre ku të studiojnë** (PISA 2018).
- Ka **boshllëqe të rëndësishme të lidhura me disponueshmërinë e kompjuterave dhe lidhjeve**, sidomos për nxënësit e familjeve me të ardhura të ulëta, që jetojnë në situata të pafavorshme apo në zona të largëta (EUROSTAT 2019, DESI 2019).
- **Mjetet VLE/LMS nuk janë njëlloj të disponueshme ndër Vendet Anëtare dhe nivelet ISCED** (Studimi i Dytë i Shkollave 2019).
- **Përdorimi i teknologjisë nga ana e mësuesve për tju përgjigjur nxënësve dhe për të krijuar përmbajtje dixhitale është më pak i përhapur** sesa për veprimtari të tjera. (ICLS 2018).
- **Vetëm 39% e mësuesve të BE ndihen të mirë ose shumë të mirë për gatitur mbi arsimin dixhital**, me diferenca të mëdha mes vendeve (TALIS 2018).

Sfida kryesore 2 – Aftësitë Dixhitale

Edhe përpara krizës, provat mbi nevojën për të mbështetur zhvillimin e aftësive dixhitale ishin të qarta:

- **43% e qytetarëve të BE-së ende kanë një nivel të pamjaftueshëm aftësish dixhitale** me pabarazi madhore mes Vendeve Anëtare (DESI 2019)
- Ka një prirje pozitive lidhur me rënien në kohë të % së individëve që nuk e përdorin Internetin, por **niveli i aftësive dixhitale mbetet ende i lidhur fort dhe thellësisht me familjet me të ardhura të larta** (EUROSTAT 2019).
- **Më shumë se një e treta e forcës aktive të punës në BE nuk zotëron aftësitë dixhitale bazë të kërkuara** në shumicën e punëve në të gjithë sektorët (CEDEFOP 2018, PIAAC 2018)
- **Më shumë se një e treta e nxënësve 13-14 vjeçarë punon nën nivelin minimal të njohurive** përsa i përket aftësive dixhitale (ICLS 2018) dhe **vetëm 20 prej 55 juridiksioneve në Europë ofrojnë arsim mbi shkencat kompjuterike dhe informatikën** për të gjithë studentët (CECE 2017, EURYDICE 2018).
- **Ka ndarje dixhitale të vazhdueshme të lidhura me gjininë, prejardhjen socio-ekonomike dhe zonat urbane/rurale** (EUROSTAT 2019). Ndarja dixhitale është gjithnjë e më shumë e lidhur edhe me cilësitë e përvojës në përdorimin e pajisjeve, sesa thjesht me aksesin ndaj tyre (EU Kids Online 2020).

Sfida kryesore 3 – Një ekosistem dixhital i besuar i përbërë nga përmbatje, mjete dhe platforma arsimore.

- Shumë Ministri të Arsimit dhe organizata të tjera publike/private ndër Vendet Anëtare, u përpoqën të **lehtësojnë aksesin ndaj përmbatjes, mjeteve dhe platformave arsimore** (EU Council Survey, 2020).
- Gjetja e një përgjigjeje të përshatshme nuk ishte e lehtë, sidomos për **sektorë specifikë të arsimit** si ATP-ja, dhe **vlerësimi** ishte një problem madhor për të gjithë nivelet arsimore (burime të ndryshme).
- Një studim i kohëve të fundit (thujse 5,000 pjesëmarrës nga më shumë se 40 vende) tregon se **më pak se 8% e mësuesve mendojnë se praktikat e edukatorëve do të rikthehen në normalitet** pas përfundimit të krizës dhe 44% mendojnë se institucionet arsimore do të ofrojnë **më shumë mësim në distancë dhe online se më parë** (School Education Gateway, 2020).
- Nëse hartohen dhe planifikohen si duhet, mundësitë e mësimin online mund të ndihmojnë në plotësimin e nevojave për mësimin gjatë gjithë jetës të një popullate nxënësish në rritje të vazhdueshme, e megjithatë **vendet europjane janë adoptues të vonë** të këtyre mundësive, me një ofertë të shpërndarë në mënyrë të pabarabartë ndër Vendet Anëtare dhe jo përherë të lidhur me kurrikulat kombëtare.
- **Përdorimi i të dhënave, privatësia dhe etika** janë elementë të rëndësishëm që duhen konsideruar si duhet.

Përditësimi i Planveprimit të Arsimit Dixhital: parimet drejtuese

- Pjesë e objektivave të Komisionit në **mbështetje të tranzicionit dixhital në Europë**.
- Do të reflektojë mbi **mësimet e mësuara nga kriza e COVID-19** dhe do të **ndërtojë mbi Planveprimin e parë të Arsimit Dixhital**.
- Një qasje më **strategjike** dhe **ambicioze** ndaj arsimit dixhital, me një **fushë veprimi më të gjerë** përtej arsimit formal dhe me një **kohëzgjatje më të madhe**.
- Pjesë e planit të rimëkëmbjes së **BE-së Next Generation**.
- **OBJEKTIVI KRYESOR:** mbështetja e institucioneve të arsimit dhe trajnimit tëShteteve Anëtare dhe e qytetarëve në përpjekjet e tyre për tu përballur me ndryshimin dixhital

Konsultimi i hapur me publikun i lançuar në 18 Qershor

- Një **konsultimi i hapur me publikun** mbi mësimet e mësuara nga kriza COVID-19 është lançuar nga 18 Qershori 2020 deri në 4 Shtator 2020: <https://ec.europa.eu/info/law/better-regulation/have-your-say/initiatives/12453-Digital-Education-Action-Plan/public-consultation>
- **Grupet Target:** qytetarë, prindër, mësues dhe edukatorë, sektori privat, etj. me mundësinë për tu përgjigjur si individë apo organizatë.

Falemnderit!

EAC-DIGITALEUCATION@ec.europa.eu



Adresimi i sfidave të arsimit dhe aftësive dixhitale përmes kornizave dhe mjeteve europjane të aftësive dixhitale

Yves Punie

JRC (Qendra e Përbashkët për Kërkime), Komisioni Europjan



Adresimi i sfidave të arsimit dhe aftësi dixhitale përmes kornizave dhe mjeteve europjane të aftësi dixhitale

Yves Punie, PhD


*Zëvendës Kryetar i Njesisë, Kapitali Njerëzor dhe Punësimi,
Qendra e Përbashkët për Kërkime (JRC), Sevilje*

Webinar i ETF, 23 Qershor 2020

Sfidat kryesore të aftësive (dixhitale) në Europë


- Rreth 70 milionë europjanë nuk kanë aftësi të mjaftueshme leximi, shkrimi dhe numërimi
- 24% e popullatës së BE-së nuk ka diplomë të shkollës së mesme
- 13% e europjanëve **nuk e kanë përdorur kurrë internetin**
- 43% e popullatës së BE-së dhe 35% e forcës së punës në BE kanë **aftësi dixhitale të pamjaftueshme**
- 42% e atyre pa aftësi dixhitale janë të **papunë**
- Të lindurit dixhitalë ≠ kompetencës dixhitale
- Me Covid-19, aftësitë dixhitale tani edhe më thelbësore se kurrë më parë

Treguesi i Aftësive Dixhitale (DESI)



Kornizat e aftësive dixhitale të QBK/KE

- Korniza e aftësive dixhitale për qytetarët (**DigComp**) dhe testimi i vetë-pasqyrimit
- Korniza e aftësive dixhitale për arsimtarët (**DigCompEdu**) dhe testimi i vetë-pasqyrimit
- Korniza e aftësive dixhitale për organizatat arsimore (**DigCompOrg**) dhe një mjet vetë-pasqyrimi për aftësitë dixhitale të shkollave (**SELFIE**)



#SELFIE_EU




Qëllimet: Kuptim dhe gjuhë e përbashkët; përmirësim i aftësisë dixhitale

Përdorime të shumëfishta: Rishikim i kurrikulave, trajnim i mësuesve, (vetë) vlerësim/pasqyrim, politika, nisma praktike, punëkërkues, certifikim, matje, etj...

DigComp

Aftësia dixhitale përfshin përdorimin e sigurtë, kritik dhe të përgjegjshëm, si edhe angazhimin me gamën e plotë të teknologjive dixhitale për mësim, në punë dhe për pjesëmarrje në shoqëri.

(Rekomandim i Këshillit mbi Kompetencat Kryesore për Mësimin gjatë gjithë Jetës, 22 Maj 2018, ST 9009 2018 (INT))



Sektorët e aftësive	Aftësitë
1. Alfabetizimi informatik dhe me të dhënat	1.1 Kërkimi dhe filtrimi i të dhënave, informacionit dhe përmbajtjes dixhitale 1.2 Vlerësimi i të dhënave, informacionit dhe përmbajtjes dixhitale 1.3 Administrimi i të dhënave, informacionit dhe përmbajtjes dixhitale
2. Komunikimi dhe bashkëpunimi	2.1 Ndërveprimi përmes teknologjive dixhitale 2.2 Bashkëpërdorimi përmes teknologjive dixhitale 2.3 Angazhimi qytetar përmes teknologjive dixhitale 2.4 Bashkëpunimi përmes teknologjive dixhitale 2.5 Netiketa (etiketa e rrjetit) 2.6 Administrimi i identitetit dixhital
3. Krijimi i përmbajtjes dixhitale	3.1 Zhvillimi i përmbajtjes dixhitale 3.2 Integrimi dhe ripërpunimi i përmbajtjes dixhitale 3.3 Copyright-i dhe licencat 3.4 Programimi
4. Siguria	4.1 Mbrojtja e pajisjeve 4.2 Mbrojtja e privatësisë dhe të dhënave personale 4.3 Mbrojtja e shëndetit dhe e mirëqënies 4.4 Mbrojtja e mjedisit
5. Zgjidhja e problemeve	5.1 Zgjidhja e problemeve teknike 5.2 Identifikimi i nevojave dhe përgjigjet teknologjike 5.3 Përdorimi krijues i teknologjive dixhitale 5.4 Identifikimi i boshllëqeve në aftësitë dixhitale

Përforcimi i DigComp

- Në përdorim tashmë në >16 vende anëtare të BE-së; në vendet fqinje në bashkëpunim me ETF; >70 projekte dhe >500,000 çertifikata DigComp të lëshuara nga aktorë të jashtëm
- Udhëzimet e reja të DigComp për punësimin: Raste studimore & udhërrëfyes për zbatimin (Qershor-Korrik 2020)
- Pilotimi i një mjeti të vetë-pasqyrit (fundi i 2020-ës)
- DigComp 2.2 (2021)



<https://ec.europa.eu/jrc/en/digcomp>

JRC SCIENCE FOR POLICY REPORT

European Framework for the Digital Competence of Educators

DigCompEdu

Christine Redecker (Author)
Yves Punie (Editor)




- Botuar në Nëntor 2017
- > 30.000 shkarkime unike
- Përshkruan se çfarë do të thotë për arsimtarët të zotërojnë aftësitë dixhitale
- Arsimitarë të të gjitha niveleve të arsimit
- 6 sektorë aftësish – 22 aftësi – 6 nivele njohurie

<https://ec.europa.eu/jrc/en/digcompedu>

Educators' professional competences

Educators' pedagogic competences


Learners' competences



Përforcimi I DigCompEdu

- Zhvillimi i një mjeti **vetë-pasqyrimi** për arsimtarët
- Provë eksperimentale (mjet për Check-In): 22 pyetje; ~28.000 përdorues (ES, IT, DE, PT, LT, SI, EN, RU) + Amerika Latine (Rrjeti i Arsimit të Lartë MetaRed)
- Në Spanjë, versioni për Arsimin e Lartë (Shtator-Dhjetor 2020)
- Piloti i plotë SELFIE për mësuesit (Mes-2021)

<https://ec.europa.eu/jrc/digcompedu/self-assessment>




SELFIE: mbështetja e aftësive dixhitale të shkollave

- Një mjet vetë-pasqyrimi falas, online, i lehtë për tu përdorur dhe i përshtatshëm për shkollat.
- SELFIE u vu në përdorim nga Komisioneri Navracsics në 25/10/2018
- SELFIE NUK është një pyetësor i ri -> është një mjet “për” shkollat që duhet bërë nga drejtuesit e shkollave, mësuesit dhe nxënësit
- Prodhon raporte të shkollave për pasqyrime, monitorime & planveprime; të dhënat janë anonime dhe “në pronësi” të shkollave
- Tashmë i disponueshëm në 35 gjuhë
- Në zhvillim e sipër: SELFIE-VET ËBL



#SELFIE EU



SELFIE: të dhëna mbi përdorimin (10.4.2020)

627.670 pjesëmarrës – 4.938 shkolla

(6.181 Nivele shkollore)

✓ 82% nxënës (458.679)

✓ 15% mësues (86.634)

✓ 3% drejtorë shkollash (16.696)

Nga këta 627.670 përdorues (>30 vende)

✓ 28 % Spanjë (174.181)

✓ 28% Ballkani Perëndimor & Turqia (173.383)

✓ 14,4% Bullgari (90.267)



Falemnderit

yves.punie@ec.europa.eu
@yves998

<https://ec.europa.eu/jrc/en/research-topic/learning-and-skills>



© European Union 2020

Nëse nuk shkruhet ndryshe, ripërdorimi i këtij prezantimi është i autorizuar nën licencën [CC BY 4.0](https://creativecommons.org/licenses/by/4.0/). Për çdo përdorim ose riprodhim të elementeve që nuk janë në pronësi të BE-së, leja mund të kërkohet direkt nga mbajtësit e të drejtave përkatëse.



Qasja politika e para dhe instrumentat e saj për të promovuar arsimin dhe aftësitë dixhitale

Fanny Seree and Christophe Masson

Drejtoria e Përgjithshme për Fajnjësinë dhe Negociatat për Zgjerimin (DG NEAR), Komisioni Europjan



Qasja politika e para dhe instrumentat e saj për të promovuar arsimin dhe aftësitë dixhitale

DG NEAR

**Webinar shumwgjuhsh 2 - Rikonceptimi i Aftësive & i Mësimit
Dixhital në vendet e Europës Juglindore dhe Turqi -
Mjetet dhe instrumentet e BE-së**

**Bruksel
23/6/2020**

Aftësitë dixhitale dhe arsimit dixhital janë pjesë e dialogut rreth politikave me vendet partnere

- Dialogu rreth politikave bëhet në nivel dypalësh (kryesisht) dhe në nivel rajonal (takim ministror)
- Delegacionet e BE-së janë në vijën e parë, në mbështetje të vendeve partnere
- Sfidë që përsëritet është zbatimi i reformave në sektorin e arsimit and aftësitë e dobëta institucionale
- Dialogu rreth politikave duhet ushqyer me fakte dhe të dhëna si p.sh. SELFIE mbi aftësitë dixhitale
- Mbështetja dhe programimi i BE-së do të ushqehen gjithnjë e më shumë nga dialogu rreth politikave

Diagnozë e Sektorit të Arsimit në Ballkanin Perëndimor

- *Diagnozat në 6 vendet e BP do të shërbejnë si mjet për dialogun rreth politikave dhe hartimin e politikave, për të informuar programimin, reformat dhe investimet*
- *Diagnozat do të analizojnë qeverisjen dhe financimin e sistemeve të arsimit në rajon, si edhe cilësinë, relevancën dhe barazinë.*
- *Arsimi dixhital do të shihet në nivel horizontal në seksionet e ndryshme të diagnozave në mënyrë të vecantë përsa i përket relevancës, aksesit dhe cilësisë.*
- *Nisur nga diagnozat do të formulohen rekomandime me autoritetet kombëtare*
- *Këto rekomandime do të drejtojnë mbështetjen për reformat, programimin*
- *Diagnoza si mjet për më shumë mbështetje në sektorin e arsimit*
- *Ushtrimi i diagnozave do të lidhet me forume të tjera dhe me kornizat e programimit*

Programet e Reformës Ekonomike

Diagnozat e Arsimit në vendet e Ballkanit Perëndimor do të sigurojnë prova për identifikimin e sfidave dhe reformat strukturore. Ato do të ushqejnë ciklet e ERP-së që është gjithashtu një mjet për programimin dhe financimin.

Objektivat janë të shumëfishta:

- ❖ Identifikimi i dobësive
- ❖ Formulimi i rekomandimeve
- ❖ Planifikimi i reformave strukturore
- ❖ Informimi i programimit
- ❖ Tërheqja e investimeve
- ❖ Përmirësimi i qeverisjes së financimit dhe arsimit
- ❖ Rritja e cilësisë dhe relevancës së arsimit

Cikli i ardhshëm i programimit: IPA III

- ❑ Qasja e bazuar mbi fakte dhe diagnoza janë pjesë e kornizës së programimit të IPA III;
- ❑ Vendet partnere pritet të pasqyrojnë reformat strukturore të identifikuara dhe diskutuara në ciklet ERP në përgjigjen e tyre strategjike dhe kërkesat për fonde nga IPAIII
- ❑ Si mund të ndikojë kjo tek reformat në arsim dhe financimin e tyre?
- ❑ Si e ndikon dialogu rreth politikave planifikimin strategjik në arsim?

Po programi Erasmus+ ?


- Erasmus + pritet të pasqyrojë përparësitë e KE-së si *green deal* dhe dixhitalizimi
- Përbërës i Erasmus + i përdorshëm në vendet partnere ku politikat dhe reformat në arsim janë në lojë: ndërtimi i kapaciteteve në arsimin e lartë (projekte strukturore dhe për zhvillimin e kurrikulave)
- Ministritë e Arsimit në Vendet Partnere janë të përfshira në projektet strukturore të ndërtimit të kapaciteteve
- Në të ardhmen diskutimet e tashme në Erasmus+ rreth rolit të rritur të dialogut rreth politikave në formimin e instrumenteve dhe drejtimin e reformave.
- Impakti i covid 19 në arsim dhe ndryshimet e pritura (trajnimi i mësuesve, aftësitë dixhitale, mësimi bazuar tek puna...)

Ju falenderojmë për vëmendjen

Pyetje & Përgjigje

Drejtojani pyetjet tuaja

Fanny Seree and
Christophe Masson



Mësimi dhe Aftësitë

Dixhitale

**Cili është faktori më
i rëndësishëm për të
sjellë mësimin
dixhital në klasë?**

Bashkëpunimi rajonal

Mjetet dhe Instrumentet e BE-së

Strategjitë e vendeve

Ju falenderojmë!

Ju lutemi të shprehni mendimin tuaj duke plotësuar formularin (kërkon vetëm një minutë) – shikoni lidhjen në chat